



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 03.06.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I
NDRYSHUAR””

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjet e datës 21.05.2019, 28.05.2019 dhe 03.06.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 21.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm dy nga firmëtarët e projektligjit, Z.Ulsi Manja, Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut si dhe Z. Adnor Shameti, anëtar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.

Relatore e projektligjit ishte znj.Ermonela Felaj (Valikaj).

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar në përputhje me nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji adreson disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal në fushat e mëposhtme:

- i. Mbrojtja nga dhuna e profesionistit shëndetësor;
- ii. Mbrojtja nga dhuna e policit, funksionarit publik, të zgjedhurit dhe personelit të shërbimit publik;
- iii. Rendi dhe qetësia publike/ndalimi i zhurmave;
- iv. Mbrojtja nga dhuna në sport;
- v. Mbrojtja e e të drejtës së autorit;
- vi. Ndalimi i veprimtarisë së lojrave të fatit;
- vii. Dekriminalizimi i gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut;
- viii. Përdorimi i armëve dhe lëndëve plasëse pa leje të organeve shtetërore;
- ix. Mbrojtja nga kafshët shoqëruese në publik;
- x. Mbrojtja e mjedisit;
- xi. Siguria ushqimore.

Domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje, si prishja e qetësisë dhe rendit (goditja e policit), dhuna në shëndetësi, dhuna në aktivitete sportive, dhuna ndaj funksionarëve publike apo të zgjedhurve ka lindur referuar ngjarjeve të muajve të fundit ku incidentet e dhunës kundër mjekëve, ato në ndeshjet sportive, goditja ndaj policit apo veprat e dhunës kundër deputetëve e të zgjedhurve të tjerë kanë qënë të shpeshta. Parashikimet aktuale në Kodin Penal, rezultojnë se nuk garantojnë parandalimin për veprimet e dhunës. Dispozitat përkatëse në Kodin Penal për dënimin e këtyre fenomeneve ose kanë mangësi, ose sanksionojnë dënime të lehta ose nuk ekzistojnë. Me qëllim dënimin e cdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri, propozohet ashpërsimi i dënimeve për veprat e dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik si dhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Nevoja për ndryshime në Kodin Penal mbi çështjet për mbrojtjen e të drejtës së autorit vjen si pasojë e debatit të gjerë publik për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë kundër kopjimeve apo përdorimeve të padrejta të veprave të të tjerëve. Në Kodin Penal ka disa parashikime për mbrojtjen e pronësisë intelektuale apo riprodhimin e padrejtë të veprës së tjetrit, por dispozitat nuk janë të plota sa i takon mbrojtjes së të drejtës së autorit, dhe dënimët përkatëse nuk i përgjigjen realitetit me qëllim parandalimin e këtyre fenomeneve shqetësuese për shoqërinë.

Ndryshimet që propozohen për ashpërsimin e dënimeve në veprimtarinë e lojrave të fatit janë pasojë e legjislacionit të ri në vend për ndalimin e veprimtarisë së lojrave të fatit dhe bixhozit.

Amendimet në lidhje me rendin dhe qetësinë publike janë pasojë e ankesave në rritje të qytetarëve anëmbanë vendit, që subjektet tregtare nuk respektojnë kërkesat e

legjislacionit për zhurmat dhe synojnë ashpërsimin e dënimeve në rastet kur ka tejkalim të normave të lejuara me ligj për zhurmat në mjedise që prishin qetësinë publike.

Projektligji propozon dhe dekriminalizimin e gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut. Këto ndryshime synojnë të përmirësojnë klimën në të cilën profesionistët e shëndetit kryejnë detyrën e tyre dhe përmbushin misionin e tyre. Dispozita ekzistuese e Kodit Penal gjatë zbatimit të praktikës gjyqësore ka sjellë gjithmonë e në rritje vështirësi për profesionistët e shëndetit të kryejnë detyrat e tyre. Kjo ka sjellë edhe zhvillimin e praktikave të ashtuquajtura të “mjekësisë difensive”. Megjithatë, për rastet kur dëmet e ndjeshme mbi shëndetin e pacientit vijnë si rezultat i mashtrimeve apo veprimeve të paligjshme, propozohen ndëshkime në raport të drejtë me dëmin e shkaktuar.

Projektligji propozon ashpërsim të dënimeve për mbajtjen e armëve, armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore apo pa leje të organeve kompetente si dhe të veprimeve që synojnë pengesat apo ndalimin me çdo mjet e mënyrë, të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror. Këto ndryshime kanë si qëllim frenimin e përdorimit të armëve apo lëndëve plasëse si dhe parandalimin e veprimeve që pengojnë qarkullimin e transportit në kundërshtim me parashikimet ligjore. Nje amendim për ndalimin e prodhimit, mbajtjes dhe përdorimit të armëve bërthamore propozohet me qëllim përmbushjen e detyrimeve të vendit nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

Ndryshimet që propozon projektligji në fushën e mbrotjes së mjedisit kanë për qëllim të transpozojnë plotësisht Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal, (*Raporti i Progresit për vitin 2016 thekson faktin se Direktiva për Krimin në Mjedis nuk është transpozuar ende*).

Projektligji përcakton dhe veprat penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia dhe të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë ose shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut. Legjislacioni në fushën e mjedisit dhe të rrezatimeve jonizuese ka avancuar mjaft kohët e fundit, duke transpozuar në legjislacionin tematik/administrativ të vendit pjesë të rëndësishme të Acquis së BE për mjedisin, të miratuar në përputhje me Traktatin e KE-së dhe aktet për rrezatimet jonizuese të miratuara në përputhje me Traktatin e Euratomit. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për Kodin Penal. Ky i fundit, për veprat penale në fushën e mjedisit, mbetet ende thjesht me parashikimet kombëtare. Problematika e deri sotme në zbatimin dhe detyrimin e legjislacionit për mjedisin ka treguar se mjedisi nuk mund të mbrohet sic duhet vetëm përmes legjislacionit specifik/administrativ. Prandaj ky legjislacion duhet të plotësohet edhe me veprat penale në fushën e mjedisit dhe sanksionet përkatëse të parashikuara në Kodin Penal. Për të siguruar një vazhdimësi dhe konsistencë midis kërkesave ligjore të legjislacionit specifik/sectorial për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese

të përafuara tashmë me ato të BE-së me parashikimet e Kodit Penal, kërkohet që edhe ky i fundit të reflektojë kërkesat e legjislacionit Evropian në fushën e mjedisit. Si pasojë e miratimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve synohet dhe pritët që të rritet shumë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit i të gjithë aktorëve që veprojnë mbi mjedisin dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre.

Gjithashtu, projektligji adreson dhe disa ndryshime të rëndësishme që lidhen me sigurinë ushqimore, si një nga çështjet më aktuale, më delikate e njëkohësisht më sensitive në ditët e sotme. Projektligji propozon rishikimin e dispozitave ekzistuese që lidhen me sigurinë ushqimore dhe krijimin e figurave të reja të veprave penale, duke kriminalizuar fenomene/sjellje të cilat aktualisht, janë kategorizuar si forma të kundërvajtjeve administrative, apo nuk kanë asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor si shkelje - të cilat nuk duhet të përfshihen në këtë kategorizim administrativ, pasi për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve juridike që synojnë të mbrojnë, natyrshëm duhet të klasifikohen si krime apo kundërvajtje penale.

Këto ndryshime kanë rëndësi tejet të lartë në funksion të garantimit të sigurisë ushqimore që është një komponent i sigurisë kombëtare, e lidhur ngushtësisht dhe me impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe jetën e popullsisë, ku mekanizmat mbrojtës duhet të bëhen efektivë në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, si hallka më e pambrojtur e zinxhirit ushqimor.

Projektligji përbëhet nga 23 nene si më poshtë:

Në nenin 1 që ndryshon nenin 50 të Kodit Penal, është shtuar si rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit për veprën penale, situata kur vepra drejtohet ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë.

Në neni 2 ndryshon nenin 96 i Kodit Penal riformulohet duke synuar dekriminalizimin e gabimit mjekësor. Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve, si veprim apo mosveprim në kundërshtim me standartet profesionale në mjekësi së bashku me pasojat që vijnë nga kjo neglizhencë do të jenë përcaktuese për përgjegjësinë penale të mjekut. Sanksioni varion nga gjobë deri në shtatë vjet heqje lirie.

Neni 3, shtohen nenin 149/c që propozon rastet e kundërvajtjes penale për shkeljen e të drejtave të autorit dhe dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Në rastin e përsëritjes apo kryerjes së veprës në bashkëpunim dispozita parashikon ashpërsim dënimi.

Në nenin 4, neni 197 riformulohet si pasojë e legjislacionit të ri për ndalimin e bixhozit dhe të lojrave të fatit. Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit, në kundërshtim me ligjin, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet. Dënimi rëndohet nëse në këto veprimtari marrin pjesë persona nën 18 vjet ose nëse

veprimtaritë organizohen nga persona të veshur me pushtet ose kryejnë funksione publike.

Nenet 5-9 kanë të bëjnë me parashikimet e neneve nga 201 deri në 203 që ndryshohen duke transpozuar Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal. Konkretisht, Neni 201 riformulohet dhe pas tij shtohen dhe 5 dispozita të reja për të ashpërsuar dënimet e krimeve mjedisore si ndotja e ajrit dhe e tokës, shkaktimi i fatkeqësive mjedisore, keqmenaxhimi i mbetjeve, transportimi i mbetjeve në kundërshtim me ligjin, zhvillimi i aktiviteteve të rrezikshme, veprimtaritë në kundërshtim me ligjin në lidhje materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme. Rrethana rënduese në caktimin e dënimit parashikohen në rastet kur shkaktohet dëmtim i rëndë në shëndetin apo vdekja e njeriut.

Neni 202 riformulohet duke synuar mbrojtjen e habitateve në zonat e mbrojtura, ndërsa neni 203 riformulohet me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i substancave ozon-holluese.

Në nenin 10, pas nenit 207, shtohet neni 207/1 që parashikon sanksionet për shkeljen e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit. Dënimi ashpërsohet në rastin e pasojave të rënda nga shkelja e këtyre rregullave, sic është plagosja apo vdekja e personit.

Në nenin 11, neni 237 “Goditjet për shkak të detyrës”, riformulohet. Ashpërsohen dënimet për goditjet dhe veprat e dhunës kundër punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, si dhe ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, që parashikohet në Kod për herë të parë si vepër penale. Dënime më të ashpra parashikohen për goditjet ndaj policit dhe profesionistit shëndetësor, si dhe kur vepra penale kryhet në mjediset e institucionit shtetëror apo në vendin ku jepet shërbimi publik, (spital, klinikë etj).

Neni 12, në të njëjtën frymë me parashikimet e nenit 237, është riformuluar dhe neni 238 “Kanosja për shkak të detyrës”.

Neni 13, pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor prezantohet si kundërvajtje e re penale dhe për këtë qëllim shtohet një dispozitë e re pas nenit 238 të K.Penal.

Neni 14, paragrafi i parë i nenit 274 “Prishja e qetësisë publike” riformulohet duke parashikuar dënimin për ushtrimin i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj.

Neni 15, shtohen dy dispozita të reja pas nenit 274, që adresojnë veprimet e dhunshme në aktivitetin sportiv si goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv apo hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv.

Ashpërsim dënimi parashikohet në rastet kur vepra kryhet më shumë se një herë apo kryhet nga drejtues ose anëtarë të klubeve sportive.

Në neni 16, neni 278 riformulohet duke ashpërsuar dënimet për mbajtjen apo përdorimin e armëve, armëve shpërthyese ose e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore. Në rast të përsëritjes apo pasojave të rënda dënimi maksimal i aplikueshëm është pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 17, është shtuar një dispozitë e re, neni 278/b, që synon ndalimin e prodhimit, mbajtjes, tregtimit të armëve bërthamore, nukleare ose kimike të dëmtimit në masë të popullsisë.

Nenet 18 dhe 19 bëjnë ndryshim në titull, repektivisht, të neneve 282 dhe 282/a si dhe disa rregullime për teknikë legjislative.

Në nenin 20, neni 288 është riformuluar dhe tre dispozita të reja shtohen pas këtij neni që synojnë ndalimin e prodhimit dhe shitjes së ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin, ndalimin e importimit, prodhimit dhe tregtimit të ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve të tjerë ushqimorë jashtë afatit të përdorimit, dënimin e mashtrimit me produktet ushqimore si dhe ndalimin e thyerjes, heqjes, zëvendësimit e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore. Dënime më të ashpra parashikohen në rastet e bashkëpunimit për kryerjen e veprës penale, përsëritjes, rastet kur shkaktohet dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ose vdekja e njeriut, vdekja e fëmijëve apo grave shtatzana.

Neni 21, pas nenit 288/b shton nenet 288/c, 288/d dhe 288/e që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore.

Neni 22, ndryshon nenin 293 që ka të bëjë me pengimin e qarkullimit të mjeteve të transportit.

Neni 23, përcakton hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare.

- ***Diskutimi në komision***

- ✚ Zoti Manja në fjalën e tij u shpreh se kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal synon të plotësojë një vakuum që ka aktualisht Kodi Penal për sa u përket veprave të reja, ashtu edhe ndryshimit të masave të dënimet për një pjesë tjetër.

Domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje synon të marrë në mbrojtje veprat penale që çenojnë prishjen e rendit dhe të sigurisë publike, dhunën në shëndetësi, dhunën në aktivitetet sportive, dhunën ndaj funksionarëve publikë apo të zgjedhur.

Me qëllim dënimit e çdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri në tërësi, propozohet ashpërsimi i dënimeve për vepra penale të dhunës ndaj punonjësve të policisë, mjekëve, sportistëve, arbitrave, ndërmjetësve sportivë, trajnerëve, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik, si edhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës, si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Mandej, Z.Manja u shpreh se nevoja për ndryshime në Kodin Penal për çështjet për mbrojtjen e të drejtës së autorit që është edhe një tjetër ndryshim, vjen si pasojë e debatit të gjerë publik për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë kundër kopjimeve apo përdorimeve të padrejta të veprave të tjerëve. Në Kodin Penal ka disa parashikime për mbrojtjen e pronësisë intelektuale apo riprodhimin e padrejtë të veprës së tjetrit, por dispozitat nuk janë të plota për sa i takon mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe dënimet përkatëse nuk i përgjigjen realitetit.

Lidhur me sigurinë mjedisore Z.Manja, u shpreh se ndryshimi ka të bëjë me transpozimin e plotë të një direktive të vitit 2008 të BE-së, që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, me masa penale, pra nëpërmjet ligjit penal, është ekzaktësisht direktiva përkatëse e BE-së. Ndërsa lidhur me sigurinë ushqimore, ai u shpreh se aktualisht kemi probleme në lidhje me sigurinë dhe garancinë e produkteve ushqimore që sot janë në treg dhe konsumohen nga konsumatorët shqiptarë. Kodi Penal, në drejtim të sigorisë ushqimore ka pasur vetëm një dispozitë ndaj dhe u pa e domosdoshme që në kreun që ka të bëjë me veprat penale të cilat marrin në mbrojtje sigurinë ushqimore të kemi edhe shtimin e disa dispozitave të reja.

Në mbyllje të fjalës së tij Z.Manja u shpreh se kjo paketë është hartuar si rezultat i një konsultimi të gjerë edhe me aktorë dhe faktorë të tjerë që kanë propozuar ndryshimet. Ne jemi një grup deputetësh të PS-së që nga pikëpamja e Rregullores së Kuvendit kemi formalizuar depozitimin e nismës, por jo vetëm kaq, një pjesë e kolegëve firmëtarë që janë edhe juristë kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në konsultimin publik dhe diskutimin e kësaj pakete, por pjesë përbërëse e hartimit të paketës kanë qenë edhe ministrinë e linjës, si: Ministria e Shëndetësisë, e cila ka bërë nëpërmjet grupit të saj të punës propozimet konkrete lidhur me dispozitat përkatëse, që propozohen për sigurinë mjekësore. Ministria e Mjedisit që ka qenë propozuesja direkte e paketës së ndryshimeve, të cilat kanë të bëjnë me krimet mjedisore, ka qenë Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe disa ekspertë të fushave përkatëse. Kemi të bëjmë me një paketë të mirëkonsultuar për të ardhur në variantin që ne kemi paraqitur në komision.

- ✚ Relatorja e projektligjit, Znj.Felaj, në fjalën e saj u shpreh se ndryshime në Kodin Penal janë propozuar nga një grup deputetësh të maxhorancës. Projektligji ka 22 nene, që i shtohen Kodit Penal, duke bërë të mundur reflektimin e disa problemeve që tashmë janë të evidentuara në praktikën gjyqësore, por që ndeshen me vakumin ligjor ose me një dënim të papërshtatshëm që nuk i përgjigjet më

nevojës që kemi për të parandaluar kryerjen e tyre, por njëkohësisht për t'i ndëshkuar sa dhe si duhet ata.

Znj.Felaj, theksoi se se në këtë komision, edhe në Komisionin e Ligjeve, shumica e anëtarëve janë juristë, kanë qenë praktikues të ligjit penal ç'ka do të ndihmojë në përmirësimin e paketës. Gjithashtu, ajo shtoi se këto ndryshime duhet të njësohen me të njëjtën gjuhë, me të njëjtën strukturë, e cila duhet të përputhet në vetvete edhe me strukturën aktuale të Kodit Penal.

Kodi Penal përfaqëson një ligj të cilësuar, duke qenë i tillë është shumë e rëndësishme që çdo gjë që shkruhet në atë ligj të jetë jetëgjatë në kohë dhe jo jetëshkurtër. Ndërhyrjet e shpeshta dhe jo të mirëanalizuara gjithmonë kanë sjellë probleme në praktikë, edhe në kuptimin, zbatimin e drejtë të dënimit për veprat të ndryshme penale.

Në fund të fjalës së saj, Znj.Felaj ftoi anëtarët e komisionit të shtronin pyetje dhe diskutime.

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet në çështjet që lidhen me arsyet e ngutjes për të bërë këto ndryshime, përderisa do të bëhet një Kod i ri Penal, ku qëndron thelbi i ndryshimeve midis kodit aktual dhe paketës që propozohet të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, nëse këto ndryshime duhet të hyjnë në fuqi para zgjedhjeve të 30 qershorit apo pas zgjedhjeve, duke qënë se ky ligj është një ligj që kërkon 84 vota a është tentuar një dakordësi edhe me përfaqësues të opozitës, etj.

Gjithashtu, gjatë diskutimit nen për nen anëtarët e komisionit u ndalën në çështje më konkrete në funksion të përmirësimit të këtyre dispozitave.

- ***Riformulime nen për nen***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit, i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës, komentet dhe sugjerimet si më poshtë:

- **Referuar nenit 1 të projektligjit**, ky nen propozon shtimin e një gërme, konkretisht shtimin e një rrethane rënduese në nenin 50 të Kodit Penal. Rrethana e propozuar është kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë.

Nuk e gjejmë me vend këtë propozim për arsyen e thjeshtë që lidhet me formulimin e kësaj rrethane rënduese. Personat e zgjedhur ose funksionarët publikë mund dhe duhet të përfitojnë mbrojtje të veçantë nga ligji, sikurse është propozuar në nene të tjera vetëm për shkak të detyrës, jo për ndonjë arsye tjetër, për arsye të tjera ata duhet të trajtohen

njëlloj si të gjithë shtetasit e tjerë apo njëlloj si të gjithë personat e tjerë. Formulimi ashtu siç është propozuar, të kryesh një vepër penale ndaj një funksionari shtetëror publik apo një të zgjedhuri dhe këtë ta përdorësh si një rrethanë për të rënduar dënimin ndaj atij që kryen një vepër nuk qëndron.

Së dyti, arsyeja tjetër është se për personat e zgjedhur dhe funksionarët publikë kemi propozuar rritjen e sanksionit penal, pra e kemi cilësuar veprën penale në rastin kur ajo ka për objekt të goditjes së saj të zgjedhurit ose funksionarët publikë. Një rrethanë nuk mund të jetë njëherazi edhe rënduese, edhe cilësuese. Në momentin që bëhet cilësuese e ka të rritur ndëshkimin, ndërsa kur mbetet rënduese gjykata ka për detyrë që ta aplikojë dhe të rrisë dënimin.

Pra, nëse vepra lidhet me motive të zbatimit të detyrës nga ana e funksionarit publik apo e të zgjedhurit, atëherë kjo mund të vlejë, por ne e kemi bërë ndërkohë këtë propozim, sepse kemi ndërhyrë te goditja për shkak të detyrës dhe e kemi cilësuar konkretisht. Prandaj e vlerësojmë si të pavend që të ndërhyhet në nenin 50.

Ose të lihet neni në fjalë siç është aktualisht ose formulimi të rishikohet, se ashtu siç është shkruar, nuk qëndron. Nuk ka pse për vepra të tjera funksionari publik apo i zgjedhuri të kenë mbrojtje të veçantë, sepse njerëzit janë të barabartë para ligjit. Mbrojtjen do ta merrte vetëm për shkak të detyrës që ushtron.

- **Referuar nenit 2 të projektligjit**, i cili bën fjalë për neglizhencën në trajtimin mjekësor, problemi i parë ka të bëjë me përdorimin e shprehjes “neglizhenca”.

Nuk jemi dakort, sepse neglizhenca është pakujdesi në vetvete dhe kjo është një ndër format e fajit. Faji është element i veprës penale, nëse nuk ka faj në kryerjen e një veprimi nuk mund të ketë vepër penale.

Ndërkohë, vetë faji ndahet në dy forma të mëdha: në dashje dhe në pakujdesi. Këto dy forma të mëdha, kanë nënforma, dashja në dashje direkte dhe indirekte, ndërsa pakujdesia në neglizhencë dhe vetëbesimi i tepruar. Se çfarë nënkupton njëra dhe tjetra janë të parashikuara në Kod, te pjesa e përgjithshme. Konkretisht, neglizhenca është rasti kur nuk i parashikon pasojat, nuk i dëshiron ndonëse kishe detyrimin dhe mundësinë për t'i parashikuar. Vetëbesimi i tepruar është kur një pasojat, i parashikon, por mendon se mund t'i evitosh ato në sajë të aftësive që zotëron.

Diskutimi është pak teorik dhe me propozimin e ardhur synojmë, ashtu siç është shkruar që neglizhenca në trajtimin mjekësor të dënohet, kur je i aftë profesionalisht, por nuk i kryen të gjitha ato veprime që duheshin kryer. Ndërsa vetëbesimi nuk dënohet sipas propozimit. Që këtu nuk përbën sens, sepse duke qenë një formë e fajit, faji në vetvete, do të thotë se faji duhet të ndëshkohet, pa faj nuk dënohet njeri.

Duke e formuluar në këtë mënyrë nenin 96 “*Neglizhenca në trajtimin mjekësor*” nuk e kemi zgjidhur problemin e mjekëve, sepse problemi, në gjykimin tonë, ka lindur nga zbatimi i dispozitës dhe jo nga dispozita në vetvete. Gjyqtarët dhe prokurorët shpeshherë u referohen akteve të ekspertimit që bëjnë mjekët ligjorë. Në vetvete janë përsëri kategoria e mjekëve ata që përcaktojnë për veten e tyre nëse një shkelje që mjekët kanë bërë gjatë punës ka ardhur nga pakujdesia, nga neglizhenca apo nga vetëbesimi i tepruar. Gjykojmë që t’u jepet më tepër vend opinioneve që do të merren në Komisionin për Shëndetësinë për këtë nen, sepse nga pikëpamja formale ose juridike, ashtu siç është ndërtuar dispozita që na propozohet, është e vështirë të qëndrojë apo të zgjidhë problemin.

Duket shumë subjektive se si do ta ndajmë formën e fajit, ndërkohë që faji në vetvete, pakujdesi apo jo, neglizhencë apo jo, vetëbesim i tepruar apo jo, është i dënueshëm. Ne kemi përjashtuar një nga format dhe kemi thënë se është e padënueshme. A mos duhet të mbajmë një qëndrim, ose ta dekriminalizojmë tërësisht këtë veprë, ose ta depenalizojmë tërësisht këtë gjë dhe ta lëmë si një shkelje mjekësore që le të dënohet nga kodet mjekësore.

- **Neni 3** parashikon shtimin e një neni të ri në Kodin Penal me titull “*Shkelja e të drejtave të autorit*”, dispozitë kjo e cila shtohet në seksionin “*Mashtrimet*”.

Dispozita e propozuar po të krahasohet me nenin 149 “*Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit*” të Kodit Penal, do të vërejmë se të dyja këto dispozita trajtojnë të njëjtën gjë.

Në gjykimin tonë kjo dispozitë e propozuar përplasat me dispozitën aktuale, sepse çdonjëra nga këto forma që përmban kjo dispozitë, në vetvete përdorim është. Pra, personi përdor veprën e tjetrit që mund të jetë veprë letrare, mund të jetë veprë shkencore, mund të jetë një këngë, një kompozim e të tjera pa lejen e autorit, ose e riprodhon tërësisht nën emrin e vetë, ndërkohë që e ka bërë një tjetër, ose i përdor në një nga këto mënyrat që propozohen që do të thotë se ne përdorimin edhe tani e kemi të penalizuar.

Pra, meqenëse të drejtat e llojeve të tjera, pronësi industriale dhe tipografike, janë të mbrojtura në mënyrë të veçantë, pra ngelet që vetëm të drejtën për veprat kulturore, artistike, shkencore të mund të mbrohen, sugjerojmë që nenin 149 të rishikohet në përmbajtje, duke i ndryshuar titullin në “*Shkelje e të drejtave të autorit*” dhe ta riformulojmë pa qenë nevojë që të bëjmë një nen tjetër të ri.

- **Neni 4** parashikon ndërhyrjen në nenin 197 të Kodit Penal, që bën fjalë për organizimin e lotarive të palejuara.

Organizimi i lotarive, i lojërave të fatit apo bixhozit janë të dënueshme aktualisht me gjobë apo burgim deri në 3 muaj.

Dispozita duhet shkruar pak më mirë duke ndarë paragrafët nga njëri-tjetri dhe dënimi duhet të përshkallëzohet nga një paragraf në tjetrin si rregull. Në qoftë se në paragrafin e dytë, të tretë apo të katërt flasim për një veprë të kryer në një rrethanë që e rëndon atë, edhe dënimi duhet të vijë, përgjithësisht si mekanizëm, duke u rënduar, jo duke u zbutur.

E dyta, është thënë “organizmi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit”. Sugjerojmë ta heqim fjalën “i veprimtarive”, sepse lojërat e fatit nuk mund të konsiderohen veprimtari dhe të themi: “Organizimi dhe ushtrimi i lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit dënohet.....”.

Në paragrafin e dytë është propozuar që në rast se këto lojëra bëhen me të mitur nën 18 vjeç, të dënohen më rëndë.

Jemi dakort me propozimin, por dispozita duhet shprehur më drejte.

Gjithashtu, sugjerojmë të hiqet shprehja “fëmijë nën 18 vjeç”, sepse Kodi Penal në çdo nen të tij, përdor shprehjen “të mitur” dhe e ka të përkufizuar se çfarë nënkupton me termin “të mitur”.

Në paragrafin e fundit thuhet: “Pjesëmarrja në lojërat e fatit dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit”.

Ky paragraf me paragrafin e parë krijon pak problem, sepse në paragrafin e parë thuhet: “organizmi dhe ushtrimi”, pra ushtrimi i lojërave të fatit dënohet.

Po të ushtrosh lojëra fati do të thotë të marrësh pjesë në to, vetëm në qoftë se ideja ka qenë *organizimi dhe ushtrimi si veprimtari ekonomike i lojërave të fatit*, se në fakt ato si veprimtari ekonomike janë ushtruar.

Në këtë rast do duhet që në paragrafin e parë të kësaj dispozite, të bëhet saktësimi duke u shprehur “organizimi.... si veprimtari ekonomike... etj”

- **Referuar neneve 5, 6, 7, 8 dhe 9**, kemi të bëjmë me veprat penale që lidhen me mjedisin, të cilat shtohen te kreu i veprave penale që lidhen me mjedisin e që janë ndotja e ajrit dhe e tokës, shkaktimi i fatkeqësive mjedisore, menaxhimi i mbetjeve, transportimi i mbetjeve, aktivitetet e rrezikshme, materialet bërthamore dhe substancat e rrezikshme radioaktive, dëmtimi i specieve të mbetura të florës e të faunës së egër, habitatet në zonat e mbrojtura, si dhe substancat ozonholluese.

Së pari, është e domosdoshme futja e këtyre neneve, sepse në këtë kre Kodi ynë Penal reflekton një realitet krejtësisht të lënë pas me dekada me radhë. Pra, ka 30 vjet, që ne mbajmë në Kodin tonë Penal të njëjtin kuadër ligjor për veprat penale kundër mjedisit, kur dihet se veprimtaria e njeriut në mjedis është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme. Bashkë me veprimtarinë e njeriut në mjedis, janë rritur edhe pasojat që i vijnë mjedisit, pasoja të cilat nuk mund të na lënë indiferentë, sepse të gjithë jemi pjesë e këtij mjedisi, e sigurisht që pësojmë dëmtime në jetën e në shëndetin tonë, deri në përfundime të rënda e fatale si humbja e jetës.

Megjithatë, kemi disa sugjerime dhe komente për këtë grup nenesh.

Vlerësojmë se mekanizmi i dënimit, që është përdorur në disa nene, është mekanizëm i pazakontë për Kodin tonë Penal.

Pra, çfarë është propozuar në disa nene?

Të dënohet me gjobë, dhe/ose me burg, nga një masë minimale dënimi deri në një masë maksimale dënimi.

Sjellim në vëmendjen tuaj se Gjykata Kushtetuese e ka shpallur antikushtetuese dhënien e dy dënimeve kryesore njëherazi, pra, të japësh edhe gjobë, edhe burg, dhe për sa kohë që ky vendim i Gjykatës Kushtetuese ekziston si i tillë, ne nuk mund të aplikojmë në Kodin tonë Penal dënime që shkojnë bashkë: edhe gjoba, edhe burgju.

Nga ana tjetër, po të shohësh gjithë Kodin Penal, në mbi 300 nenet e tij, ose më pak se kaq, nëse heqim pjesën e përgjithshme, mënyra se si operohet të dënimi, është: ose gjobë, ose burg. Brenda dënimit me burg, kemi minimalen e dënimit me burgim, dhe maksimalen, që fillon nga pesë ditë deri në 35 vjet ose burgim i përjetshëm.

Kësisoj, sugjerojmë që llojin dhe masën e dënimit të rishikohet në të gjitha dispozitat e propozuara. Njëkohësisht, të shihet edhe marzhi i dënimit, sepse në disa vende konstatojmë se hapësirat janë lënë shumë të gjera dhe dihet që hapësirat shumë të gjera, lënë vend gjithmonë për abuzim ose për korrupsion.

- Me **nenin 10 të projektligjit**, i cili reflekton nismën e shoqatave për mbrojtjen e kafshëve dhe jo vetëm, propozohet të shtohet një nen, me titullin “Shkelja e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimin”, nen ky që synon të mbrojë së pari, personat nga përdorimi ose nga mbajtja e kafshëve jo në mënyrë adekuate.

Formulimi “Mosvendosja e maskës së qenve agresivë” duket shumë subjektiv.

Mendojmë se duhet shprehur ndryshe, për shembull: “mbajtja e maskave për kafshët (qen) e racave, që dihen se janë realisht të rrezikshëm për njeriun, të jetë e detyrueshme”, por duke e specifikuar për cilën racë, jo ta lëmë kështu në përgjithësi, në mënyrë që të mos i vendoset maskë një qeni, që nuk është i rrezikshëm.

Pra, të shmangen nga gjuha e dispozitës shprehje që lënë vend për subjektivitet ose vlerësime të natyrës subjektive.

- Referuar **nenit 11 të projektligjit**, janë bërë disa propozime për veprat penale, që kanë të bëjnë me goditjen për shkak të detyrës, që, në fakt, kanë të bëjnë edhe me qëndrimin që kemi mbajtur në publik si mazhorancë. Pra, për shkak të shtimit në mënyrë të ndjeshme të rasteve të goditjes të personave publikë, të zgjedhur ose jo (gjithnjë rastet e goditjes së tyre kanë qenë të lidhura me detyrën e tyre), kemi ndeshur problematikën që dënimi i parashikuar në Kodin Penal aktual nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar ndodhjen e akteve të tilla.

Si komision kemi disa vërejtje për këtë nen dhe konkretisht:

Në dispozitën e propozuar është përdorur shprehja “funksionarë publikë dhe persona në shërbim publik”.

Po të shikojmë Kodin Penal, në kreun e krimeve kundër autoritetit të shtetit, në seksionin që ka të bëjë me veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit, përdoret shprehja: “punonjës që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik”, pastaj në veprën penale të korrupsionit flitet për persona që ushtrojnë funksione publike, që përfshin ata që punojnë në shërbimin publik, si dhe për funksionarët e lartë shtetërorë.

Vlerësojmë që duhet të jemi të kujdesshëm në ndërtimin e kësaj dispozite ose në ndërhyrjen te kjo dispozitë, duke i renditur në mënyrën e duhur subjektet konkrete, të cilave duam t’u japim mbrojtje të veçantë duke i shndërruar në subjekte të posacme. Dhe konkretisht subjektet të cilët duhen ndarë vecmas, në paragraf të veçantë janë të zgjedhurit funksionarët e lartë shtetërorë dhe mjekët, sepse kategoria tjetër e punonjësve në shërbim publik ose e funksionarëve shtetërorë, është e parashikuar në paragrafin e parë sipas dispozitës së propozuar.

Për sa i përket goditjes ndaj punonjësve të policisë, nuk jemi që ndërhyrja ta reflektohet te neni 237, sepse ky nen ka qenë i ndarë nga nenet 235 dhe 236 që kanë për subjekt punonjësit e policisë, por për punonjësit e policisë ndërhyrja të bëhet te neni 236 i Kodit Penal, i cili titullohet “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

Të ndryshojë titulli i këtij neni dhe të bëhet “Kundërshtimi i punonjësit të policisë”, sepse ndaj të njëjtit sulm (goditjes ose vepra të tjera dhune) mund të vihen dhe janë vënë jo vetëm punonjësit e policisë së rendit publik, por edhe ata të policisë kriminale, të policisë së qarkullimit rrugor e të tjerë.

Pra, le të përdorim termin e përgjithshëm “punonjës policie”, se nuk e kemi term abstrakt, por e kemi të përkufizuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, duke u dhënë kështu mbrojtje të veçantë të gjithë punonjësve të policisë së shtetit.

- **Referuar nenit 12 të projektligjit**, që ka të bëjë me “Kanosjen për shkak të detyrës”, komenti është i njëjtë si në nenin 11.

Pra, të mos ngatërrohet kuptimi i “punonjës shtetëror në shërbim publik” me “funksionar publik”, sepse “funksionar publik” e përfshin kategorinë e punonjësve shtetërorë në shërbim publik.

Ndërsa se çfarë kuptohet me “funksionarë të lartë shtetërorë” ose cili është rrethi i të tillë personave, kjo është e njohur tanimë, sepse citohet në disa ligje.

- **Neni 13 i projektligjit** i referohet pengimit të ushtrimit të detyrës të profesionistit shëndetësor.

Për këtë nen kemi vërejtje për sa i përket llojit të dënimit, është parashikuar vetëm dënimi me gjobë.

Sikundër e kemi shprehur dhe më sipër dhënia e dënimeve fikse është antikushitetuese sikundër brenda një minimale dhe maksimaleje të përgjithshme të një dënimi kryesor sikur është dënimi me gjobë, duhet përcaktuar një marzh minimumi dhe maksimumi sipas rëndësisë së vetë veprës.

- Me **nenin 14 të projektligjit**, propozohet një ndërhyrje në nenin 274 të Kodit Penal, “Prishja e qetësisë publike” duke marrë shtysë nga zhurmat që rëndom krijojnë lokalet, baret kryesisht, në zona apo lagje të ndryshme. Pamundësia për t’i disiplinuar ato me masat aktuale, ka çuar në propozimin e një paragrafi të tillë në nenin 274 të Kodit Penal që parashikon prishjen e qetësisë publike.

Është propozuar të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon, gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë ose me burgim deri në 2 vjet”.

Së pari, përsa i përket formulimit, do të kishim këto konsiderata;

Natyrisht që veprimtari të ndryshme ekonomike gjenerojnë zhurmë, por nuk duhet të dënohen thjesht dhe vetëm për këtë fakt.

Duhet të dënohen në rastet kur zhurma gjenerohet në zona të banuara duke krijuar shqetësim dhe kur ajo kalon limitet e përcaktuara me ligj.

Vlerësojmë se nuk duhet dënuar vetëm ushtrimi i këtyre veprimtarive ekonomike që shkaktojnë zhurmë në mjedise të banuara nga njerëzit, por pjesë e qartë e dispozitës, sa i takon anës objektive të saj, duhet të bëhen edhe lokalet. Sugjerojmë riformulimin e dispozitës duke përcaktuar qartë se rasti që kërkohet të penalizohet është ai i lidhur me zhurmat që krijohen përtej limiteve të lejuara, në mjedise të banuara.

Të rishikohet mekanizmi i dënimit, pasi që në të, shprehen dy lloje dënimi kryesore, secili me masa minimale dhe maksimale njëkohësisht, çfarë e trajtuam dhe pak më lart.

- **Neni 15 i projektligjit**, shton dy nene; nenin 274/a “*Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv*” dhe nenin 274/b “*Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive*”.

Së pari për teknikë legjislativë, sugjerojmë që secili nga nenet e propozuar për t’iu shtuar Kodit Penal, të shprehet si dispozitë më vete në projektligj, konkretisht neni 15 shton nenin 274/a dhe neni 16 shton nenin 274/b, çka passjell edhe ndryshimin në renditje të neneve pasuese të propozuara në projektligj.

Në lidhje me nenin 274/a, sugjerojmë që termi “ndërmjetës sportiv”, nëse nuk është i njohur si i tillë në ndonjë akt ligjor që rregullon fushën e sportit, nuk mund të përdoret në këtë dispozitë pasi përbën shkak për moskuptim.

Gjithashtu, vërejmë së minimumi i dënimit, si në paragrafin e parë ashtu edhe në të dytin, është i njëjtë, 1 vit.

Sugjerojmë që në paragrafin e parë të hiqet ky minimum mase dënimi dhe ky paragraf të riformulohet si më poshtë:

*“Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim **deri në tre vjet**”.*

Në lidhje me nenin 274/b, i cili rinumërohet si neni 16 i projektligjit, anëtarët e komisionit sugjeruan që ky nen të ndahet në 4 paragrafe duke u riformuluar si më poshtë:

Neni 274/b

Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive

Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të një aktiviteti sportiv, e personave të paautorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Hedhja me dashje e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po këto vepra, kur kryhen gjatë aktiviteteve sportive ndërkombëtare, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.”.

- **Neni 16 i projektligjit**, të rinumërohet si neni 17, dispozita të ndahet në dy paragrafë, ku në paragrafin e parë diapazoni i dënimit të jetë nga 5 deri në 8 vjet, si më poshtë:

Neni 17

Në nenin 278, paragrafi i parë, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyesë ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

- **Neni 17 i projektligjit**, rinumërohet si neni 18 ,dhe duke qenë se fjala “bërthamore” dhe “nukleare” kanë të njëjtin kuptim, sugjerojmë që fjala “nukleare” të hiqet.

- **Në nenin 18 dhe 19**, të cilët rinumërtohen respektivisht si neni 19 dhe 20 i projektligjit, sugjerojmë që togfjalëshi “substancia radioaktive” të mos hiqet sepse nuk është e njëjta gjë me “lëndët plasëse” dhe “lëndët djegëse”.
- **Neni 20 i projektligjit** ka të bëjë me prodhimin dhe shitjen e ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin.

Ky nen rinumërtohet si neni 21 i projektligjit.

Anëtarët e komisionit treguan ndjeshmëri të lartë për këtë çështje.

Gjithsecili prej nesh është konsumator i përditshëm i produkteve ushqimore dhe garantimi në shkallën më të lartë të shëndetit të qytetarëve, duhet të jetë prioritet për ligjvënësin.

Anëtarët e komisionit sugjeruan ashpërsimin më tej të masës së dënimit në paragrafin e parë të veprës, me qëllim parandalimin maksimal të kësaj vepre, pa pritur verifikimin në praktikë të pasojës së rëndë në jetën dhe shëndetin e personit.

- **Neni 21 i projektligjit**, shton nenet 288/c, 288/d dhe 288/e që kanë të bëjnë respektivisht me importimin, prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve të tjerë ushqimorë jashtë afatit të përdorimit, mashtrimin me produktet ushqimore si dhe thyerjen, heqjen, zëvendësimin e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore.

Për teknikë legjilative neni 21 i cili shton nenin 288/c rinumërtohet si neni 22, ndërsa neni 288/d dhe 288/2 kalojnë si dispozita më vete të projektligjit duke u rinumërtuar respektivisht si neni 23 dhe neni 24.

Gjithashtu, në lidhje me nenin 288/c, u sugjerua të shtohet një paragraf ku të dënohet vecmas importi i produkteve ushqimore të cilat janë në prag skadence ose kanë skaduar.

Në nenin 288/d, u sugjerua ashpërsimi i masës së dënimit të propozuar në paragrafin e parë që ka të bëjë me paraqitjen e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore apo barnave.

Në lidhje me nenin 288/e, u sugjerua që në paragrafin e parë, veprimet e përshkuara në përmbajtjen e dispozitës së propozuar, të mund të penalizohen sipas Kodit Penal, vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha masat administrative më parë.

- **Neni 22 i projektligjit**, të rinumërtohet si neni 25.

- Neni 23 i projektligjit, të rinumërtohet si neni 26.

Përfundim

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Kryetar / Relator

Ermonela (Felaj) VALIKAJ